Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 02.07.2024 vit.god. | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02 - | 035 | 02 - | 926 |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr 28/2008), lidhur me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 23.12.2016, Kryetari i Komunës së Vitisë, me datë 02.07.2024 merr këtë:

# V E N D I M

## Për ndryshim-plotësim të Vendimit Nr.02-035/02-172 e datës 28.02.2024

**I.** Me këtë vendim Kryetari i Komunës së Vitisë bënë ndryshim-plotësim të vendimit me nr.02-035/02-172 e datë 28.02.2024 për formimin e komisonit për shyqyrtimin e kërkesave për shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

**II.** Konformë pikes I të këtij vendimi për formimin e komisonit për shyqyrtimin e kërkesave për shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore ku pika I i vendimit nr. 02-035/02-172 e datës 28.02.2024, anëtari me nr.rendor 2- z.Islam Jashari, zëvendësohet me znj.Arta Muharremi.

**III.** Të gjitha pjesët tjera të Vendimit me nr.02-035/02-172 e datës 28.02.2024 për formimin e komisonit për shyqyrtimin e kërkesave për shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore mbesin të pandryshuara.

**IV.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

**V.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Anëtarëve të Komisionit,
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA
Pranuar - Primljeno 28-02-2024
02-035/02-172

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

Kryetari i Komunës së Vitisë bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008), Ligjit nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr.04/L-247, po ashtu bazuar në vendimin e Ministrit nr.3234/22 të datës 03.06.2022 për vazhdimin e afatit për paraqitjen e kërkesave për blerjen e banesave nga bartësit e së drejtës banesore, dhe nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, me datë 28.02.2024, merrë këtë:

## V E N D I M
## PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR SHITJEN E BANESAVE PËR TË CILAT EKZISTON E DREJTA BANESORE

**I.** Me këtë vendim kryetari i Komunes së Vitisë formon komision për shqyrtimin e kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, për katësisht shfrytëzuesit e banesave në pronësi shoqërore apo publike për të cilat ekziston e drejta e banimit.

Komisioni përbëhet prej 3 Anëtarëve dhe ka ketë përbërje:

1. Fadil Hoxha - Kryetar i komisionit
2. Islam Jashari - Anëtar
3. Arian Alidema - Anëtar

**II.** Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për shitjen e banesave për te cilat ekziston e drejta banesore, përkatesishtë ti shqyrtoj kërkesat e bartësve të së drejtës pronësore të cilat dhënësit e banesave janë të instucioneve publike, lokale, si dhe për banesat për të cilat është vërtetuar se shitësi i tyre është i panjohur, ti njoftoj bartësit e të drejtës banesore përkatësisht shfrytëzuesit e banesave për të drejtën e blerjes së banesës si dhe kompletimin e dokumentacionit që duhet ti bashkangjitet kërkesës.

**III.** Të drejtën e shitjes e bartë komuna në territorin e së cilës gjendet banesa dhe mjetet nga shitëblerja e banesave transferohen në buxhetin e Komunës së Vitisë.

**IV.** Për kryerjen e detyrave si në piken II të këtij vendimi kryesuesi i këtij komisioni raporton Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktur (Divizionin e Banimit).

**V.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimi nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:
1. Anëtarëve të Komisionit
2. Zyrës së Kryetarit
3. MMPHI
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti